



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2024:078625

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05507546

**P.nr.102/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit M. H. nga J., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.550/24, të datës 07.03.2024, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesen e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me datën 12.03.2024, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr.550/24, të datës 07.03.2024 dhe kjo gjykatë jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

Ndaj të pandehurit:

**M. H.** i lindur me datë .... në V. e Zh., me adresë banimi fshati J. KK L., nga i ati Ismajl, e ëma V., me numër personal ..., shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse:**

Prej datës së pavërtetuar deri më datën 10.11.2023, në adresën fshati J. KK L. punëtorët e KEDS-it, gjatë një kontrole tek i pandehuri me numër unik DFE-130842, në njehsorin elektrik me numër 87415469, kanë konstatuar se i njëjti, me qëllim që vetit t'i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, ka keqpërdorur energjinë elektrike, në atë mënyrë që gjatë kontrollit është hasur në lidhje direkte jashtë pikës matëse, është picku kablli furnizues nën çati, është kyç direkt pa matje kati i dytë i shtëpisë, ku pas kontrollit eliminohet keqpërdorimi, me çka të dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 191.53-€,

-Me çka ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së.

Andaj gjykata, në konform të dispozitave të lartcekura dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së, neneve 493, 495 si dhe nenit 364 të KPPRK-së, të pandehurin e gjykon me:

**DËNIM ME GJOBË**

Me dënim me gjobë në shumë prej 100-€, të cilin dënim i pandehuri është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim,

konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

**DETYROHET** i pandehuri që të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Ferizaj, t'ia kompenzoj dëmin material në shumë prej 191.53-€, pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

**DETYROHET:** i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor ti paguaj shumën prej 20-€, si dhe për kompensimin e viktimave të krimit ti paguaj shumën prej 20-€, në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PTH-së në Prishtinë, PP/II.nr.550/24, të datës 07.03.2024, e ka akuzuar të pandehurin M. H. nga J., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me par.6 të KPRK-së dhe njëkohësisht ka kërkuar që të pandehurit t'i shqiptohet urdhër ndëshkimor - dënim me gjobë për veprën e lartcekur penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarin M. H. i dt.24.02.2024, fatur KESCO e dt.02.02.2024, kallëzimit penal numër CMS-K/DFE-300 i datës 10.11.2023, fatura DFEHP2323723 e dt.30.08.2023, procesverbali nr.2064716 i dt.19.08.2023, procesverbal nr.0216486 i dt.17.06.2023, dhe fotografit e vendit të ngjarjes, si dhe shkresave tjera të lëndës konstaton se ka prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohen, andaj gjykata të njejtin e shpalli fajtor dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për veprat penale për të cilat parashihet dënim me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do t'i shqiptojë dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqyrtimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurit nga arsyet se dënimi për veprën penale me të cilën ngarkohet i akuzuari është dënim me gjobë apo me burgim deri në 3 vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 449 dhe 450 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompenzimin e viktimave të krimit u mur në bazë të nenit 36 të Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesen pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN**  
**P.nr.102/24, me datën 12.03.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**  
Gentiana Dakaj

**GJYQTARI**  
Avdirrahman Gashi

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në kundërshtim në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e marrjes së të njëjtit, kundërshtimi i drejtohet gjyqtarit individual të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2024:078625  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05507546